

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot

Data 03.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburante për vitin 2026” e ndare sipas loteve:

Loti I Gasoil D1

Loti II Benzinë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09100000-0 Karburante, 09132000-3 Benzinë, 09134000-7 Naftë.

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.070.350 (pesë milionë e shtatëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH e ndarë në Lote:

Loti I “Gazoil D1”: 4.445.990 (katër milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) pa TVSH.

Loti II “Benzinë”: 624.360 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I- Gazoil D1

LOTI II: Benzine

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a). Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 101.470 (njëqind e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë) Lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës për te dy lotet së bashku).

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti I: 88.919,8 (tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë presje tetë) Lekë.

Loti II: 12.487,2 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë presje dy) Lekë.

b). Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, te ndryshuar nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.*

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Në të cilin parashikohet se: “Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërket operatoreve ekonomike nuk mund të tejkalohet: (c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.”*

Kërkesa e mësipërme është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK sh.a për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Vlera e xhiros që kërket është në përputhje me vlerën e përcaktuar në nenin 43 pika 2.c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

3. Kapaciteti teknik:

3.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës për secilin nga lotet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4, b ku përcaktohet shprehimisht, citojmë: " Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

3.1.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme profesionale për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse për përdorim nga Konsumatorët Fundorë, për gazoilin dhe benzinen e kërkuar, lëshuar nga Organi i Qeverisjes Vendore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 40, pika 5, gërma a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar i cili parashikon se

Neni 11: Personat juridikë, që i nështrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:

- a) rafineri naftë, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit të naftës bruto;
- b) naftësjellës e gazsjellës, që ushtrojnë veprimtarinë e transportimit të naftës bruto dhe të gazit natyror (kategoria O);
- b/1) impiante të përpunimit;
- c) shoqëritë e tregimit me shumicë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit me shumicë të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre dhe lëndëve që shërbejnë si lëndë djegëse
- ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të karburanteve , gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante për automjete
- d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Neni 17: Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse janë të detyruar të pajisen me licencë koncesioni, licencë përpunimi licencë tregtimi ose autorizim.

Neni 20 “Licencat” i Ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar parashikon se:

1. Licencat u jepen personave juridikë, të parashikuar në pikat “ç” dhe “d”, të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës

dhe vajrave lubrikante për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse).

2. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.
3. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.
4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

3.1.3. Raport testimi, për cilësinë e gazoilit dhe benzinës, në përputhje me specifikimet teknike sipas shtojcës 6 në DT, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI).

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 40 pika 6 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, i cili parashikon se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.³⁸ Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) **dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.**

Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel” si dhe VKM Nr. 491, datë 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirembajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, kreu V.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

3.1.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), që subjekti ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislationit shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit.

Argumentim: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM Nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave

dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” të ndryshuar, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

3.1.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dorëzojë një deklaratë/listë të stacioneve të shitjes (shpërndarjes) të gazoilit dhe benzinës, me adresat e tyre, e cila të vërtetojë që ofertuesi të ketë stacione shitje të gazoilit dhe benzinës në rajonin ku ushtron veprimtarinë e saj Shoqëria Rajonale Ujësjetelës Kanalizime Korçë sh.a konkretisht në Korçë, në Ersekë, në Bilisht, si dhe në Tiranë.

Argumentim: Në bazë të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë stacione të shitjes të gazoilit dhe benzinës në Korçë, në Ersekë, në Bilisht, si dhe në Tiranë.

Disponimi i stacioneve të tregtimit të karburantit në Korçë, në Ersekë, në Bilisht kërkohet për shkak se Korça, Erseka, Bilishti e janë vendet e ushtrimit të aktivitetit të AK Shoqërisë Rajonale Ujësjetelës Kanalizime Korçë Sh.A.

Disponimi i stacioneve të tregtimit të karburantit në Tiranë kërkohet për shkak se punonjësit e AK kryejnë në Tiranë, lëvizje me automjete për arsye pune, si takime, mbledhje, seminare, trajnime etj, me ditë qëndrimi më shumë se një ditë dhe mund të ndodh që të lindë nevoja për furnizim me karburant me kartën elektronike, në stacionet e tregtimit të karburantit në Tiranë.

Kriteri është hartuar në këtë mënyrë duke patur parasysh natyrën e objektit të prokurimit i cili është furnizim me karburant, për një efikasitet sa më të lartë në përdorimin e tij. Sa më afër të jetë pika e furnizimit me karburant aq më të ulta janë kostot për autoritetin kontraktor.

3.1.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ISO 9001:2015, ose ekuivalente (për të vërtetuar që operatori i plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë) lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është hartuar në mbështetje të nenit 79, pika 1, ku citohet si vijon: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë...”

Gjithashtu bazuar edhe në neni 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”.

Për vetë natyrën dhe rëndësinë e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që, operatorët si zbatues të kontratës, të kryejnë veprimtarinë në përputhje me standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve, reputacionit dhe besueshmërisë së operatorëve ekonomikë. Konkretisht: ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, e cila

mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

LOTI I

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të dhënat teknike të Gazoil D1 Të dhënat teknike të Gazoil D1 i referohen standardit evropian (EN 590:2025) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):

Specifikimet teknike sipas S SH EN 590:2025.

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e testimit

Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë		Metoda e testimit Në përputhje me
		Minimum	Maksimum	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	ASTM D 613
Indeksi i cetanit		46,0	-	S SH EN ISO 4264:2018
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820,0	845,0	ASTM D 7777
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d, e}	% (m/m)	-	8.0	S SH EN ISO 12916:2024 ASTM E 1655-17

Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	10,0	S SH EN ISO 20846:2019
Pika e flakërimit	°C	55	-	EN ISO 2719 ASTM D 93
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	S SH EN 6245:2002
Pika e bllokimit të filtrit në të ftohtë CFPP ⁺	°C			S SH EN 116“2015
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		S SH EN ISO 2160:1999
Përmbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v		7,0	S SH EN 14078:2025
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	S SH EN ISO 3104:2023
Përmbajtja e ujit	% (m/m)		0,020	S SH EN ISO 12937:2003 (2000)
Lubriciteti, diametri i korektuar i gervishtjes	µm		460	S SH EN ISO 12156-1:2018
Ndotja e Pergjitheshme	mg/kg		24	EN 12662
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³		25	EN ISO 12205
Distilimi :				
Distilati që vlon deri në 250°C,%(v/v)	% v/v		65	EN ISO 3405:2019
Distilati që vlon deri në 350 °C,%(v/v)		85		
95 % (v/v) distilon në	°C		360	

Plotësimi i kërkesave të mësipërme, përveç deklarimit nga ana e operatorit ekonomik, do të shoqërohen edhe me flet analizën përkatëse, e cila do të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme vetëm nëse analiza është kryer nga një laborator shtetëror apo i autorizuari prej tij, dhe në përputhje me Standardin S.SH.EN 590:2025.

UKRK Sh.a gjithashtu do të bëjë testime ose inspektime shtesë të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se gazoili është konform specifikimeve dhe kushteve teknike të kërkuara. UKRK Sh.a do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Konkretisht UKRK Sh.a, për çdo furnizim, do të kryejë analizimin e gazoilit tek Laboratori Shtetëror i Kontrollit i ISHTI Tiranë.

UKRK Sh.a me cilesinë e blerësit ka të drejtë dhe mund të kryejë verifikimin e sasisë të gazoilit, në prani të furnizuesit, me metodën e peshimit, pesha bosh dhe pesha plot dhe konvertimi në litra do të bëhet në bazë të densitetit të gazoilit.

Blerësi UKRK Sh.a do të refuzojë çdo sasi gazoili që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

Sasia e mallit që kërkohet: 29000 litra Gazoil D1

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit do të jetë deri me 31.12.2026, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Lëvrimi do të kryhet periodikisht sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor UKRK Sh.A, nëpërmjet autobotit tek depozita e UKRK, nëpërmjet kartave elektronike në piken e shitjes në çdo moment të paraqitjes së punonjesit duke paraqitur kartën elektronike si dhe/ose nëpërmjet tollonave.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

LOTI II

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të dhënat teknike të Benzinë Premium Unl ppm i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): S.SH.EN 228:2012+A1:2017.

Specifikimet teknike sipas S.SH.EN 228:2012+A1:2017.

Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
1	Numri Oktanit Kerkimor		95	
2	Numri i Oktanit Motorrik		85	
3	Densiteti në 15 °C	Kg/m³	720	775
4	Përmbajtja e Sqfurit	mg/kg		10
5	Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë/50 °C)	Renditje	Klasa 1	
6	Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
7	Distilimi			
a	Distilon deri 70 °C	% (v/v)	20	48
b	Distilon deri 100 °C	% (v/v)	46	71
c	Distilon deri 150 °C	% (v/v)	75	-
d	Pika Finale e Distilimit	°C	-	210
e	Mbetjet e Distilimit	% (v/v)	-	2
8	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
a	Olefinat	% (v/v)	-	18
b	Aromatiket	% (v/v)	-	35
9	Përmbajtja e benzenit	% (v/v)	-	1
10	Përmbajtja e oksigjenit	% (m/m)	-	2.7
11	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore			
a	Methanol (alkool metilik)	% (v/v)		3
b	Etanol (alkool etilik)			5
c	- Alkool izopropilik		Përzjerja në vëllim i kufizuar në 2.7% (m/m) të përmbajtjes maksimale të oksigjenit	
	- Alkool izo butilik			
	- Alkool terc butil			
	- Etere (me 5 ose më shumë atome C)			
	- Komponime oksigjenore të tjera			

Plotësimi i kërkesave të mësipërme, përveç deklarimit nga ana e operatorit ekonomik, do të shoqërohen edhe me flet analizën përkatëse, e cila do të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme vetëm nëse analiza është kryer nga një laborator shtetëror apo i autorizuari prej tij, dhe në përputhje me Standardin S.SH.EN 228:2012+A1:2017.

UKRK Sh.a gjithashtu do të bëjë testime ose inspektime shtesë të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se benzina është konform specifikimeve dhe kushteve teknike të kërkuara. UKRK Sh.a do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Konkretisht UKRK Sh.a, për çdo furnizim, do të kryejë analizimin e benzines tek Laboratori Shtetëror i Kontrollit i ISHTI Tiranë.

UKRK Sh.a me cilesinë e blerësit ka të drejtë dhe mund të kryejë verifikimin e sasisë të benzines, në prani të furnizuesit, me metodën e peshimit, pesha bosh dhe pesha plot dhe konvertimi në litra do të bëhet në bazë të densitetit të benzines.

Blerësi UKRK Sh.a do të refuzojë çdo sasi benzinë që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

Sasia e mallit që kërkohet: 4400 litra Benzinë.

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit do të jetë deri me 31.12.2026, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Lëvrimi do të kryhet periodikisht sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor UKRK Sh.A, nëpërmjet autobotit tek depozita e UKRK, nëpërmjet kartave elektronike në piken e shitjes në çdo moment të paraqitjes së punonjesit duke paraqitur kartën elektronike si dhe/ose nëpërmjet tollonave.

Shënim: Kriteri i vlersimit të ofertave të Gazoil dhe benzinës është oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Njësia e prokurimit